



Republika e Kosovë
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 12-060/04-242 dt. 05/01 2021

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 21.12.2020, ora 10:00.
Mbledhjen e kryesoi Labinot Halilaj-Kryesues.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për politikë dhe financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, Gani Podrimqaku, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiqi, Burim Bujupi. Prezent gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, shefi i Kabinetit të Kryetarit Flamur Curri, Drejtori për Buxhet dhe financa Shyqyri Bublaku, Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë: Ruzhdi Lestrani dhe Drejtoresha e Drejtorisë së Ambientit dhe Planifikim Hapsinor Flutra Avdiu.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 19.11.2020.
2. Plani i Punës për vitin 2021, i Kuvendit Komunal.
3. Plani i Punës të Kryetarit për vitin 2021.
4. Propozim Rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.
5. Plani preliminar i Prokurimit për vitin 2021.
6. Diskutimi i Plani të Integritetit.
7. Propozim Vendim për financimin e Projektit "Ngritja e Mirëqenies Sociale të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Familjarëve të tyre.
8. Propozim Vendim për lirim nga qiraja joprofitabile, familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2021.
9. Propozim Vendim për këmbimin e njësive kadastrave nr. 348/0 dhe 1011/0 në zonën kadastrale në Gillogoc.
10. Propozim Vendim për përmisimin e gabimit teknik në listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2021.

11. Propozim Vendim për lirim nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarëve me autobus për linjat urbanë- periferike dhe ndër urbane që shfrytëzojnë stacionin e autobusëve në Glllogoc, për operim.
12. Raporti i dytë periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.
13. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: hapi mbledhjen e KPF, pasi përshëndeti të pranishmit, prezantoi rendin e ditës , me tri pika shtesë:10 Propozim Vendim për përmisimin e gabimit teknik në listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2021.

11.Propozim Vendim për lirim nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarëve me autobus për linjat urbanë- periferike dhe ndër urbane që shfrytëzojnë stacionin e autobusëve në Glllogoc, për operim.

12.Raporti i dytë periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Pasi nuk pati diskutime hodhi në votim rëndin e ditës , u votua ne mënyre unanime .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KPF-ca dt. 19 .11.2020.**

Burim Bujupi- Faleminderit Kryesues te çështja e procesverbalit desha me u ndërlidhë meqenëse ne shumicën e rasteve nuk dëgjohet zëri im ,desha te kërkoj qe te rregullohen këto probleme teknike dhe te mos kemi probleme per herën tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hodhi në votim pikën e parë të rendit e ditës , dhe kjo pike u votua ne mënyre unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e dyte Plani i Punës për vitin 2021, i Kuvendit Komunal.

Nëse ka dikush diçka mundeni te diskutohi , nëse jo atëherë e rekomandojmë për kuvend .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e trete Plani i Punës të Kryetarit për vitin 2021.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci – Plani nuk votohet vetëm diskutohet nëse ka ndonjë kërkesë plotësim-ndryshim ne jemi te gatshëm me e bere. Ky është një plan i punës se Kryetarit dhe te drejtoreve për vitin e ardhshëm , faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, Edhe kjo pike u votua ne mënyre unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e katërt Propozim Rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.

Fjalën e merr drejtori i arsimit Muhamet Gjoka- Kjo rregullore është ne diskutim publik deri me datën 23.12.2020 , por nëse ka ndonjë koment sugjerim për plotësim ose ndryshim te kësaj rregullore ne do ti marrim parasysh. Është rregullore qe merret me kujdesin dhe te drejtat e fëmijëve ne harmoni me ligjin ne bashkëpunim me organizatën ndërkombëtarë USAID.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-edhe kjo pike rekomandohet për kuvend ne mënyrë unanime .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e pestë Plani preliminar i Prokurimit për vitin 2021.

Fjalën e merr Drejtoresha e Administratës se Përgjithshme Kimete Qorri - Plani preliminar i Prokurimit për vitin 2021 është hartuar ne baze te listës se projekteve kapitale qe është votua ne

kuvend ndërsa kodi buxhetor për subvencione dhe mallra shërbime projektet te cilat do te përfshihen ende nuk janë përfshi jemi duke prit prej drejtorive dhe besoj gjate javës do te na përcjellin edhe titujt e projekteve dhe vlerën e planifikuar për publikim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-edhe kjo pike rekomandohet për kuvend ne mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e gjashte: Diskutimi i Plani të Integritetit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- nëse nuk ka diskutime atëherë edhe kjo pike rekomandohet për kuvend ne mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e shtate : Propozim Vendim për financimin e Projektit “Ngritja e Mirëqenies Sociale të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Familjarëve të tyre.

Fjalën e merr Drejtori i Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale Arsim Haxhiu – faleminderit kryesues Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale siç jeni ne dijeni edhe me vendimin e vitit te kaluar kam bere një propozim vendim rreth financimit te projektit Ngritja e Mirëqenies Sociale të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Familjarëve të tyre, lidhur me mbulimin e shpenzimeve te aktiviteteve këtu përfshihen kategori te ndryshme te personave me aftësi te kufizuara .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- nëse nuk ka diskutime atëherë edhe kjo pike rekomandohet për kuvend ne mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e tete Propozim Vendim për lirimin nga qiraja joprofitabile, familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2021.

Fjalën e merr Drejtori i Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale Arsim Haxhiu – faleminderit për shkak te situatës ne te cilën jemi me sëmundjen Covid-19 , familjet te cilat banojnë ne blloqet e banimit social ti lirojmë nga qiraja jo profitabile ,ka mjaft prej tyre qe janë prek nga Covid-19 dhe e kemi pa te arsyeshme te bëjmë ketë propozim vendim qe për periudhën prej 1 janari 2021 deri me 31 dhjetor 2021 duke pasur para sysh që kjo pandemi do të zgjas edhe vitin e ardhshëm ne shpresojmë që të filloi vaksinimi dhe mendojmë që është e arsyeshme të bëhet ky propozim vendime. Që sado pak të ju ndihmojmë këtyre familjeve .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- nëse nuk ka diskutime atëherë edhe kjo pike rekomandohet për kuvend ne mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e nëntë 9.

Propozim Vendim për këmbimin e njërive kadastrave nr. 348/0 dhe 1011/0 në zonën kadastrale në Glllogoc.

Drejtori për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë Ruzhdi Lestrani- Propozimi për këmbimin e këtyre parcelave është bërë me qëllim, të rregullimit të infrastrukturës rrugore.

Po ashtu pronari i parcelës nr.1011-0, Agron (Ahmet) Mala me anë të kërkesës nr.07-070-35249 datë 27.08.2020 i është drejtuar Drejtorisë për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë, për këmbimin e këtyre pjesëve të parcelave .Këmbimet e këtyre parcelave janë të domosdoshme si për pronarin e kësaj prone ku me këtë këmbim do të bëhet rregullimi dhe shfrytëzimi më i mire i pronës, po ashtu edhe për Komunën do të ishte i dobishëm ky këmbim, për ndërtimin e infrastrukturës rrugore në këtë pjesë të Komunës së Drenasit.

Ekipi profesional i Drejtorisë për Gjedoezi, Kadastër dhe Pronë ka dal në vendshiqim dhe ka bërë inçizimin e pjesës së ngastrave kadastrale të shënuara më lartë të cilat do të këmbehen, e për të cilat pjesë janë nxjerrë edhe kopjet e planit dhe certifikatat mbi të drejtat e pronës.

Të bashkangjitur e keni edhe skicën e terenit dhe certifikatat e njësive kadastrale.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- nëse nuk ka diskutime atëherë edhe kjo pike rekomandohet për kuvend ne mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e dhjetë .

10. Propozim Vendim për përmisimin e gabimit teknik në listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2021.

Drejtori për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë Ruzhdi Lestrani- në momentin kur janë përpilua listat nga AGJK i Kosovës në momentin kur i kemi nxjerr në lisat nga sistemi ,dhe ne atë kohe operatori nga sistemi ka qenë duke punuar atje dhe kur i kemi nxjerr ne të dhënat por pasi ka përfunduar azhurimi i tyre e kam vërejt qe ka pasur ndryshime në parcela ,dhe për këtë arsye kam kërkuar me u bërë ky përmisim

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- nëse nuk ka diskutime atëherë edhe kjo pike rekomandohet për kuvend ne mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën .11 Propozim Vendim për lirim nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarëve me autobus për linjat urbanë- periferike dhe ndër urbane që shfrytëzojnë stacionin e autobusëve në Glllogoc, për operim.

Drejtoresh për Emergjenca Lmnije Krap –duke marrë parasysh vështërit që kanë gjatë kohës së pandemisë d.m.th. mungesa e udhëtarëve ne si drejtorat nga kërkesat e këshillit te operatorëve të linjave që operojnë në komunën tonë kemi ardhur me këtë propozim vendim për peronizim që kushton 2 € ,si masë stimuluese, dhe mendojmë që është i arsyeshëm .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- edhe kjo pikë rekomandohet për debat në kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e 12. Raporti i dytë periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Drejtori i financave Shyqiri Bublaku –ky raport është si pjes ligjore që brenda vitit prej momentit të pranimi të Zyrës Kombëtare e Auditimit për implementimin e gjitha rekomandime që i jepin ata ,dhe ne jemi në fazën e dytë të implementimit Zyrës Kombëtare e Auditimit, pjesa dërmuese e rekomandimeve janë plotësua ,që është një rezultat i mirë .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- nëse nuk ka diskutime atëherë edhe kjo pike rekomandohet për kuvend ne mënyrë unanime

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi si të mbyllur seancën.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 11: 20min.

Procesmbajtëse:


Fakete Hoti


Kryesuesi i Kuvendit
Labinot Halilaj